

**PROF. DR. MUIN ÇAMI****(1923-2011)**

Më dt. 14 dhjetor 2011, iu dha lamtumira e fundit prof. dr. Muin Çamit, njerit ndër veteranët më të shquar të historiografisë shqiptare të shek.XX.

Prof. Muini lindi në Gjirokastrë më 13.02.1923 ku edhe kreu ciklet e para të arsimimit. Pas pauzës së krijuar nga Lufta e Dytë Botërore, gjatë të cilës u përfshi në Lëvizjen Antifashiste, në vitin 1955 u diplomua në Tiranë për histori. Dy vjet më pas më 1957 ai do të ndërpriste karrierën e nëpunësit dhe do të bëhej pjesë e kolektivit të Institutit të Historisë dhe të Gjuhësisë për t'i kushtuar gjithë jetën, dijet, aftësitë, energjinë dhe atdhetarizmin e spikatur, studimit të historisë sonë kombëtare në periudhën e viteve të pavarësisë e të konsolidimit të shtetit shqiptar dhe përpjekjeve për demokratizimin e tij.

Për rreth 55 vjet edhe pasi kishte dalë në pension, në vitin 1990, prof. Muin Çami, gjithnjë me pasionin që te ai nuk njohu moshë, me seriozitetin dhe skrupulozitetin e admirueshëm, hulumtoi arkiva, konsultoi pa fund bibliografi shkencore dhe realizoi studime të shumta e botime dokumente që rrokin një hark kohor rreth 25 vjeçar. Disa monografi, dhjetëra e dhjetëra studime bashkautorësia në vepra madhore, që njohën disa edicione, si Historia e Shqipërisë apo Historia e Popullit Shqiptar (1965, 1984, 2007), Fjalori Enciklopedik Shqiptar (1985, 2007), pjesëmarrja në shumë konferenca e simpoziume shkencore, kombëtare e ndërkombëtare (Sofje, 1966, Bukuresht 1974, Paris 1982), prania me një mori shkrimesh divulgative në median ditore e periodike, janë një pjesë e kontributeve të prof. dr. Muin Çamit, shenjuan gjurmët e tyre në historiografinë shqiptare. Kontributi i prof. Muinit shtrihet më tej në oponencën serioze e shumë profesionale për studimet e historianëve të tjerë brenda ose jashtë kuadrit të redaksisë së rev. "Studime historike", organit shkencor të Institutit të Historisë (anëtar në vitet 1967-1975), zv.kryeredaktor më 1976-1990), veçanërisht të studiuesve të rinj, të cilët i nxiste dhe i përkrahte me një dashamirësi të veçantë për të ecur përpara. Detyrat e ngarkuara të sekretarit shkencor të Instituti të Historisë dhe Gjuhësisë (1962-1971) apo të anëtarit të Këshillit Shkencor të këtij institucioni (1962-1990) ai i përdori më së miri në këtë drejtim, duke fituar respektin e dashurinë e kolegëve.

Angazhimi në fushën e pasurimit të fondeve arkivore të Institutit të Historisë, në fushën e muzeologjisë, ligjërimet me auditorët e studentëve, udhëheqjet e diplomantëve e disertantëve etj., janë një aspekt tjetër në kuadrin e kontributeve të profesorit të nderuar.

Për veprimtarinë e tij të shquar prof. M.Çami është nderuar disa herë nga institucionet shtetërore e akademike me medalje e urdhra të ndryshëm, ndër të cilët me urdhrin “Naim Frashëri” të Klasit I (1989). Ndërkohë jashtë vendit, në vitin 1999, Redaksia e botimit “Fjalori ndërkombëtar i bibliografive” (IBC) me qendër në Londër (Kembridh), e ka përfshirë atë në listën e studiuesve të merituar. Vlerësimi nuk ka munguar edhe nga qyteti i lindjes, i cili më 2005 e shënoi prof. Muin Çamin në listën e qytetarëve të nderit.

Me ndarjen e prof. Muin Çamit nga kjo jetë, historiografia shqiptare, kolegët, miqtë e natyrisht familja humbën një njeri të rrallë e të dashur.

#### **BIBLIOGRAFI SHKENCORE** **Botimet kryesore të prof. dr. Muin Çamit**

##### *I. Monografi dhe përmbledhje studimesh*

1. *Lufta çlirimtare antiimperialiste e popullit shqiptar vitet 1918-1920*, Tiranë: 1969, 217 f.. Botim i UTSH.

Libri është botuar tërësisht edhe në frëngjisht me titull: *La lutte anti-imperialiste de liberation nationale du peuple albanais*, Tiranë: 1973.

2. *Shqipëria në marrëdhëniet ndërkombëtare (1914-1918)*, Tiranë: 1987, 384 f.. Botim i Institutit të Historisë të Akademisë së Shkencave.

3. *Shqiptarët dhe francezët në Korçë (1916-1920)*, Tiranë: “Dituria”, 1999, 240 f.

4. *Lufta e Vlorës. Faktorët e fitores*, Tiranë: “Toena”, 2000, 98 f.

5. *Shqipëria në rrjedhat e historisë 1912-1924*, Tiranë: “Onufri”, 2007, 467 f.

##### *II. Bashkautor:*

1. *Historia e Shqipërisë*, vëllimi i dytë, Tiranë: 1965, f. 426-496 (botim i Institutit të Historisë dhe Gjuhësisë pranë USHT).

2. *Historia e Shqipërisë*, vëllimi i tretë, Tiranë: 1984, f. 155-244 (botim i Institutit të Historisë të Akademisë së Shkencave)

3. *Historia e Popullit Shqiptar*, vëllimi i tretë, Tiranë: “Toena”, 2007, f. 74-98, 123-245.

4. *Fjalori Enciklopedik shqiptar*, Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë: 1984 (autor i 30 zërave).

5. *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë: “Kristalina-KH”, 2009 (autor i 23 zërave të rinj)

### III. Botime dokumentesh e materialesh

1. *Kujtime dhe këngë popullore për luftën çlirimtare të viteve 1918-1920*, Tiranë: 1970, f. 368, botim i USHT (bashkëpërgatitës)

2. *Lufta e popullit shqiptar për çlirimin kombëtar në vitet 1918-1920* (Përmbledhje dokumentesh) vëll. I, II, Tiranë: 1975, 1976, 1175 faqe (bashkëpërgatitës) (Botimi i Institutit të Historisë pranë Akademisë së Shkencave dhe i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit).

### IV. Artikuj studimorë

1. “Rritja e lëvizjes nacionalçlirimtare pas Luftës së Parë Botërore – Kongresi i Lushnjës” në *Buletini i USHT*, seria për shkencat shoqërore, 1960, nr.1, f. 14-50.

2. “Shqipëria në planet e Fuqive të Antantës në fillim të Luftës së Parë Botërore (gusht 1914-prill 1915)” në *Buletini i USHT*, Seria për shkencat shoqërore, 1961, nr. 3, f. 25-52.

3. “Kufiri shqiptaro-grek në Konferencën e Paqes në Paris (janar-mars 1919)”, në *Buletini USHT*, Seria për shkencat shoqërore, 1962, nr. 2, f. 3-33.

4. “Kongresi i Durrësit dhe formimi i Qeverisë së Përkohshme (dhjetor 1918)” në *Studime historike*, 1965, nr. 2, f. 9-36. Shkrimi është botuar edhe në *Rassegna di studi albanesi*, Roma: 1966, nr. 2, f. 55-76.

5. “Marrëveshja italo-shqiptare e 20 gushtit 1919 dhe protokollit i 16 dhjetorit 1919”, në: *Studime historike*, 1966, nr. 2, f. 55-76.

6. “Pikëpamjet politike dhe shoqërore të Themistokli Gërmenjit në vitet 1915-1916”, në *Studime historike*, 1966, nr. 4, f. 131-148. Botuar edhe në *Studia albanica*, 1967, nr. 1, f. 91-102.

7. “Lëvizja kombëtare shqiptare dhe politika italiane në mbarim të Luftës I Botërore” në *Studime historike*, 1967, nr.3, f. 87-99. Botuar edhe në *Studia albanica*, 1966, nr.1, f. 67-79, po ashtu në *Actes du premier kongres internacional des studes balkaniques et sud-est europeenes*, V., Sofia, 1970, pp.103-114.

8. “Lufta antiimperialiste e Vlorës – faktor vendimtar për ruajtjen e pavarësisë dhe të tërësisë territoriale të shtetit shqiptar”, në *Studime historike*, 1968, nr.1, f. 86-93.

9. “Lufta e Vlorës – luftë e të gjithë popullit shqiptar, në: *Studime historike*, viti 1970, nr. 3, f. 89-101. Botuar edhe në *Studia albanica*, 1971, nr.1, f. 79-90.

10. “Orvatjet e qeverisë së Durrësit dhe të pushtuesve italianë për ndalimin e Kongresit të Lushnjës dhe dështimi i tyre, në përmbledhjen *Kongresi i Lushnjës dhe Lufta e Vlorës*, Tiranë: 1974, f. 19-54 (përgatitur në bashkëpunim).

11. “Lëvizja demokratike dhe revolucionare shqiptare në vitet 1921-1924”, në *Studime historike*, 1974, nr. 3, f. 33-48. Botuar edhe në *Studia albanica*, 1975, nr.1.

12. “Lëvizja kombëtare në trevën e Korçës në muajt e fundit të pushtimit francez (prill-maj 1920)”, në *Studime historike*, 1975, nr.2, f. 49-72. Botuar edhe në *Studia albanica*, 1977, nr.1, f. 57-77.

13. “Protokolli shqiptaro-grek i Kapshticës (Rrethanat e nënshkrimit dhe karakteri)” në *Studime historike*, 1975, nr. 4, f. 75-92. Botuar edhe në *Balkan bibliography*, vol.IV-1975 (suplement), Thessaloniki: 1977, pp.127-144 (Botim i Institutit të Studimeve Ballkanike në Selanik).

14. “Hyrja në Shqipëri e forcave austro-hungareze dhe qëndrimi i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare”, në *Studime historike*, 1976, nr.2, f. 45-58.

15. “Krahina “autonome” e Korçës dhe reagimi i huaj”, në *Studime historike*, 1976, nr.4, f. 83-101.

16. “Lëvizja Kombëtare në trevën e Korçës në vitet 1916-1920 (Fitorja e saj, karakteri dhe rëndësia)”, në *Studime historike*, 1977, nr.1, f. 71-92.

17. “Rreth dënimit të Themistokli Gërmenjit dhe ekzekutimit të tij”, në *Studime historike*, 1977, nr.4, f. 95-122.

18. “Lëvizja demokratike revolucionare shqiptare në vitet 1921-1924”, në përmbledhjen *Çështje të lëvizjes demokratike dhe revolucionare shqiptare në vitet 1921-1924*, Tiranë: 1977, f. 5-24.

19. “Armëpushimi i vitit 1918 dhe Shqipëria”, në *Studime historike*, 1978, nr.4, f. 61-91. Botuar edhe në *Studia albanica*, 1978, nr. 2, f. 129-166.

20. “E vërteta mbi burimin dhe përmbajtjen e një parulle të hedhur në Shqipëri më 1920”, në *Studime historike*, 1979, nr.1, f. 241-252.

21. “Lufta e Vlorës – luftë e lavdishme popullore me rëndësi të madhe historike”, në *Studime historike*, 1980, nr.4, f. 113-127. Botuar edhe në *Studia albanica*, 1980, nr.2, f. 41-56.

22. “Kongresi i Lushnjës dhe pushtuesit italianë (Sipas disa dokumenteve të Komandës italiane të pushtimit)”, në *Studime historike*, 1980, nr. 3, f. 83-89.

23. “Aspekte themelore të lëvizjes kombëtare dhe demokratike shqiptare në vitet 1913-1920”. Botuar në *Studia albanica*, 1982, nr.1, f. 297-317. Botuar me shkurtime në *La crise balkanique de 1908 a 1912 et l'indépendance de l'Albanie*, f. 37-44. Botim i L’Institut National des Langues et Civilisations Orientales, Paris: 1984.

24. “Mbi rolin e Bajram Currit në shtypjen e lëvizjes reaksionare sadiste më 1920”, në librin: *Bajram Curri (Trajtesa e dokumente)*, Tiranë: 1982, f. 69-77. Botim i Institutit të Historisë.

25. "Fan S. Noli për mbrojtjen e pavarësisë dhe të tërësisë territoriale të Shqipërisë 1914-1918", në *Studime historike*, 1984, nr. 2, f. 81-101.
26. "Bilanci i vitit të parë të qëndresës antifashiste në Tiranë, në: Studime historike", 1985, nr.1, f. 27-41.
27. "Solidaritet dhe përkrahje e popullsisë së Tiranës ndaj luftës së popullit grek kundër agresionit të Italisë fashiste (1940-1941)", në *Studime historike*, 1985, nr. 4, f. 85-97.
28. "Mbi aleancat politike e klasore në shoqërinë shqiptare gjatë viteve 1912-1921", në *Studime historike*, 1985, nr. 1, f. 157-160.
29. "Pushtimi malazet i Shkodrës dhe qëndresa kundër tij", në *Buletini shkencor*, botim periodik i Universitetit të Shkodrës, 1985, nr.1, f. 107-119 dhe nr.2, f. 101-110.
30. "Shqipëria në marrëdhëniet midis Fuqive të Antantës më 1915-1916", në *Studime historike*, 1986, nr.3, f. 117-134.
31. "Lenini për Shqipërinë", në *Studime historike*, 1987, nr. 4, f. 141-150.
32. "Gjirokastra përballë agresionit fashist të prillit 1939", në *Studime historike*, 1988, nr.4, f. 41-58.
33. "Kongresi i Lushnjës – programi dhe masat për realizimin e tij", në *Studime historike*, 1990, nr.2, f. 95-108.
34. "Lufta e Vlorës dhe shtypi socialist Italian", në *Studime historike*, 1990, nr.3, f. 99-111.
35. "Vitet e fundit të Çerçiz Topullit", në *Studime historike*, 1991, nr.1, f. 185-198.
36. "Kompromisi Nitti i janarit 1920 dhe qëndrimi i Jugosllavisë ndaj problemit shqiptar", në *Studime historike*, 1992, nr. 1-4, f. 43-56.
37. "Kleri i lartë ortodoks në Shqipëri dhe Lëvizja Kombëtare Shqiptare në vitet 1912-1921", në botimin *70 vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Tiranë: 1993, f. 42-52 (Botim i Institutit të Historisë).
38. "Kalvari i Shqipërisë pas Shpalljes së Pavarësisë", në *Studime historike*, 1997, nr. 1-4, f. 119-124.
39. "Mendimi politik dhe veprimtaria e Nikolla Ivanait në vitet 1919-1920", në *Studime historike*, 1998, nr.1-2.
40. "Gjirokastra në udhëkryqet e historisë (1912-1920)", në *Studime historike*, 1999, nr. 1-2, f. 167-176.
41. "Tirana kryeqytet – peng i intrigës dhe i politikës", në *Studime historike*, 2000, nr. 3-4.
42. "Mbi harmonizimin e ndërjegje kombëtare me atë fetare në Shqipëri (1921-1924)", në revistën *Të drejtat e njeriut*, 2000, nr. 3.
43. "Mendimi politik i gazetës "Drita" mbi Luftën e Vlorës", në *Studime historike*, 2001, nr.3-4, f. 79-97.
44. "Usharakët francezë në Korçë – mbështetës të aspiratave kombëtare të popullsisë", në *Studime historike*, 2002, nr. 1-2, f. 61-78.

45. “Mbi vështirësitë e stabilizimit të shtetit shqiptar (1912-1914)”, në *Studime historike*, 2003, nr. 1-2, f. 177-186.

46. “Jehona e vdekjes së Vudro Uilsonit në mjedisin shqiptar”, në: *Studime historike*, 2004, nr. 1-2, f. 33-47. (Me rastin e 80-vjetorit të vdekjes).

47. “Himara në vitet 1912-1924 (vështrim historik)”, në vëllimin *Himara në shekuj*, Tiranë, Akademia e Shkencave, Tiranë: 2004, f. 191-210.

48. “Domosdoshmëria e Luftës së Vlorës”, në *Studime historike*, 2005, nr. 3-4, f. 137-144.

48. “Skënderbeu, frymëzues i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare”. Botuar në vëllimin *Skënderbeu dhe Evropa*, Tiranë: 2006. Botim i Institutit të Historisë, 2006, f. 7-8.

49. “Mbi krijimin e Komitetit të Mbrojtjes Kombëtare të Kosovës”, në *Studime historike*, nr.2, Tiranë: 1991, f. 129-133.

**Marenglen VERLI**

